



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:167147

Datë: 29.09.2023

Numri i dokumentit: 04734436

**P.nr.2131/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit V. M. nga F. K., i akuzuar për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2950/2021 të datë 28.07.2021, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 21.09.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi, i akuzuari V. M., me datë 22.09.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.09.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

V. M., i biri i B. dhe nëna H. e gjinisë M., i lindur me ..., në P., me vendbanim në rr. ‘Y. i D.’ fshati M. e P. nga F. K., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datë 16.04.2021, rreth orës 22:10, te rrethi në F. K. gjatë një kontrole nga ana e Policisë të veturës G., ngjyrë e kuqe me targa te regjistrimit ..., të cilën e ngiste i pandehuri V., te i cili është gjetur një qese e vogël me substancë narkotike të llojit marihuanë që pas ekzaminimit të mostrave të marra nga substanca narkotike është konstatuar se qesja përmbanë narkotik të llojit Kanabis (marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), pesha neto e përgjithshme 2.6 +/- 0.00001 gram, të cilën i pandehuri e ka poseduar paautorizim.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9,10 par.1, 17 par.1, 21 par.1, 38, 39 par.1 nen par.1.1, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 par.1 nen par.1.2 dhe 1.3, 72, dhe nenit

269 par 1 të KPRK-së dhe neneve 240, 241, 242 par. 1 dhe 6, 358, 359, 360, 361 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurin V. M. e gjykon me:

## **DËNIM ME BURG ME KUSHT DHE DENIM ME GJOBË**

- I.** Për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, të akuzuarit V. M., Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej tre (3) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti nëse i akuzuari gjatë kësaj periudhe nuk kryen vepër të re penale si dhe dënim me gjobë në shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro
- II.** Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në shumë si më lart, gjykata do ti zëvendësoj të pandehurit dënimin me gjobë, në dënim me burg duke llogaritur 1 (një) ditë me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- III.** Në bazë të nenit 269 par.1 të KPPRK-së konfiskohet substanca narkotike e llojit Marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 2.6 +/- 0.00001 gram.
- IV.** Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, URDHËROHET asgjësimi i substancës së cekur në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë.
- V.** Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.2950/2021 të datë 28.07.2021, ndaj të akuzuarit V. M. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.09.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Nazmi Krasniqi, të akuzuarit V. M., ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pas deklaramentit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si në aktakuzë. Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është e vetëdijshëm për pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklaramentimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2021-AE-0501, i datës 16.04.2021, Raporti i Policisë J. G. #..., i datës 16.04.2021, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit i datës 16.04.2021, Raporti i njësisë së forenzikës i datës 16.04.2021, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 16.04.2021, raport i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë i datës 25.06.2021 si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit V. M. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur faktin e rrezikshmërisë së lartë shoqërore të këtyre veprave penale.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjukata në kuptim të nenit 70 të KPRK-se të pandehurin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit. Gjukata në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 71 të KPRK-së për zbutjen e dënimit, meqenëse rrethanat e lartcekura gjykata i konsideroj si rrethana posaçërisht lehtësuese.

Gjukata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjukata gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Gjukata vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor e mori në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 par.3 nën par.3.1 Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.2131/21 më datë 29.09.2023

**Bashkëpunëtori Profesional**

**Gjyqtarja e vetme Gjykuese**

**Albrim Kastrati**

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.